



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08.10.2024

Nr: 183

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË ELBASAN, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E KOALICIONIT “BASHKË
FITOJMË”, Z. YMER ISUF BALLIU

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 4059 prot., datë 03.09.2024, këshilli i bashkisë Elbasan, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Franko Bardhul Hakilja, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për këshillin e bashkisë Elbasan, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 13, z. Ymer Isuf Balliu.

Me shkresën nr. 2624, prot., datë 9.09.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan, z. Ymer Isuf Balliu, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 08.10.2024 Nr:183
Ora:12:00



Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan me kandidatin nga lista shumëmemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Ymer Isuf Balliu

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Koalicionit Bashkë Fitojmë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër EL-BF-4166_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Ymer Isuf Balliu, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 2715 prot., datë 16.09.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2714 prot., datë 16.09.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Ymer Isuf Balliu.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10269/1 prot., datë 27.09.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Ymer Isuf Balliu, ku konstatohet se kandidati ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e emrit dhe mbiemrit nga “YMER BALLIU” në “JORGO BINJAKU” dhe më pas nga “JORGO BINJAKU” në “YMER BALLIU”.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 14693/1 prot., datë 20.09.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Ymer Isuf Balliu, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Ymer Isuf Balliu në këshillin e Bashkisë Elbasan, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Elbasan, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Ymer Isuf Balliu.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI